



Komuna Skenderaj

Njësia për të Drejtat e Njeriut.
Zyrtaria për Barazi Gjinore



**STOP
DHUNËS**

MOS HESHT!
BËJE HESHTJEN ZË!

Shtypin e kësaj fletëpalosje e mundësoj
Drejtoria e Shëndetësisë
Komuna e Skenderajt

Dhuna në familje është akt që shkel të drejtat e njeriut. Viktima të formave më ekstreme të dhunës janë gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar.

Dhuna në familje ushtrohet në disa forma :

Forma më e rëndë është dhuna fizike ku përfshihen shtyrjet, goditjet, gërvishjet, kërcënimi me thikë apo me armë, tentativa për vrasje apo vrasja .

Parandalimi i dhunës në familje

Parandalimi i dhunës duhet të bëhet që në fëmijërinë e hershme duke filluar që nga bankat e shkollës. Pra në mënyrë që dhuna të parandalohet tek fëmijët, tregoni nxënësve vlerën dhe rëndësinë e femrës në familje dhe në edukimin e fëmijëve .

Karta Evropiane e të drejtave te njeriut thotë: "Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë me dinjitet dhe të drejta".

Dhunë në familje konsiderohet çdo shkelje e të drejtës së Gruas, Burrit dhe Fëmijëve nga personat që janë pjesëtarë të familjes. Shkaku kryesor i dhunës është pushteti i pabarabartë që ekziston mes të dy gjinive;

Dhuna në familje gjeneron dhunë.

Dhuna në familje është një fenomen me pasojë .

Dhuna në familje sjell trafikimin me genje njerëzore ;

Dhuna në familje , bënë që fëmijët të merrin me punë të keqja;

Dhuna në familje tek personat me aftësi të kufizuar sjell lypesën ne irragë .

ÇKA MUND TË BËNI

- Të jeni të vendosur dhe mos u dorëzon.
 - Të ikurit nga sitata e dhunës është një proces i gjatë dhe i mundimshëm.
 - Fillon me vendim të pretë dhe qëndrim te vendosur .
 - Çdo hap që do ta ndërmerrni për të mirën e vetës tuaj do të jetë hap me interes dhe i rëndësishëm për vërtmbështetje.
- Legislacioni Vendor dhe Ndërkombëtar ndalon qartë përdorimin e dhunës në familje ,si shkelje e të Drejtave Dhe Lirive Themelore të Njeriut, të Garantuara me Legjislacion .



Nëse përijetonit dhunën apo hasni në momente të përdorimit të dhunës tek të njerëzit, thirri (thirja është falas) në këta numra telefoni :

Tel. mobil:112

TEL.fiks:092

Sipas Ligji për Mbrojtje nga dhuna në Familje shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime :

- 1.2. Dhuna ne Familje –një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bënë një person personit tjeter me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto , por nuk kufizohet në:
 - 1.2.1. Përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjeter të familjes ;
 - 1.2.2. Çdo veprim tjeter i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos , se do të shkaktojë dhëmbje fizike dhe vuajtje psikike ;
 - 1.2.3. Shkaktimi i ndjenjës së frikës ,trezikshmëritë personale apo cenimin edinjitetit ;
 - 1.2.4 Sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat ;
 - 1.2.5. Ofendimi , sharja , thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
 - 1.2.6. Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qellim të përuljes së personit tjeter;
 - 1.2.7. Marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
 - 1.2.8. Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjeter;
 - 1.2.9. Dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
 - 1.2.10. Vënja e personit tjeter në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike,emocionale dhe ekonomike ;
 - 1.2.11. Hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjeter ;